

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria VEKO sh.p.k. , është themeluar me vendimin nr 27757 dt 18.05.2002 dhe është një shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar/shoqëri aksionare. Objekti i saj kryesor është " Prodhim dhe tregetim i artikujve te drurit".

Gjatë vitit 2019 nuk ka pasur ndryshime në lidhje me madhësinë dhe me strukturën e zotërimit të kapitalit. Në datën e këtyre PF struktura e zotërimit të kapitalit paraqitet si vijon:

Ortaku	% në kapital	Numri i pjesëve	Vlera e kapitalit në ALL
Stavro KOÇA	50 %	50	607.837.760,5
Dhimosten KOÇA	50 %	50	607.837.760,5
Totali	100 %	100	1.215.675.521

Administratori ligjor i shoqërisë është STAVRO KOÇA

Selia juridike e Shoqërisë është: Vrisera, Gjirokaster.

Shoqëria është e regjistruar si person juridik ne Drejtorinë Rajonale Tatimore të Rrethit Gjirokaster dhe me pas transferuar ne Drejtorine e Tatimpaguesve te Medhenj me NIPT : K 12511628 P

Më 31 Dhjetor 2019 shoqëria ka 107 punonjës (31 Dhjetor 2018 ka patur 96 punonjës).

2. Parimet e përgatitjes se pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara të publikuara bazuar ne urdhrin e Ministrit të Financave nr 64 datë 22.07.2014 "Për Shpalljen e Standardeve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre"si dhe ne urdherin e Ministrit të Financave nr.28 date 30.01.2019 per shpalljen e disa ndryshimeve te SKK 2 dhe SKK 9.

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK-ve të përmirësuara dhe të ligjit nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabël kryesore

Një përmbledhje të pjesës më të madhe të politikave kontabël mbi bazën e të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur sa më poshtë:

3.1 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM në dore dhe ato të mbajtura në banka.

Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshijnë MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak) Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshijnë investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.2. Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientët dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësi ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njesisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme, duke e fshirë këtë të drejtë nga librat e saj kontabël. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësi ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

Një aktiv financiar sipas përkufizimit të SKK 3 "Instrumentet financiare: Shënimet shpjeguese dhe Paraqitja" çregjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Shoqëria parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha reziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

3.3 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

i) *Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes*

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësi ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

b. Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi i klientëve apo furnitorëve, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare". Diferencat e kurseve të këmbimit të mjeteve monetare paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në zërin e Fitiemve (humbjeve) nga kursi i këmbimit, në përputhje me kërkesat e SKK 12 "Efekti i Ndryshimit të kurseve të Këmbimit".

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2019 janë:

Data /	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Monedha		
EUR	121,77	123,42
USD	108,64	107,82

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.

Shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit të vazhduar dhe metodën e koston mesatare/FIFO për matjen e inventarëve gjendje. Në datën e ndërtimit të PF shoqëria ka gjykuar që kosto e inventarit është më e ulët se vlera neto e realizueshme

3.5 Aktivët e Afatgjata Materiale dhe Jomateriale (AAM/AAJM)

(i) Njohja dhe vlerësimi

AAM dhe AAJM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. AAM paraqiten në bilanc me vlerën neto nga amortizimi

(ii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale llogaritet dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare. Ndërsa për të gjithë zërat e tjerë amortizimi llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit janë të paraqitura si më poshtë:

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

	<i>Norma Amortizimit</i>	<i>Metoda Llogaritjes</i>
	<i>%</i>	
Ndërtesa	5%	Me Vleftën e mbetur
Makineri e pajisje	20%	Me Vleftën e mbetur
Mjete Transporti	20%	Me Vleftën e mbetur
Mobile Orendi	20%	Me Vleftën e mbetur
Pajisje Informatike	20%	Me Vleftën e mbetur

3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Në detyrimet e tjera përfshihen detyrimet jotregtare dhe huamarrjet përveç llogarive të pagueshme dhe detyrimeve të tjera tregtare.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shoqëria nuk ka gjendje hua afatgjata në fund të periudhës raportuese.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga shitja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së mallit apo produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

3.9 Shpenzime për personelin

(i) Kontributet për sigurime shoqërore dhe te ngjashme

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kostot përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave me ndodhjen e tyre.

(ii) Leje e zakonshme e paguar

Shoqëria i njeh si një shpenzim personeli dhe si detyrime ato kosto që lidhen me lejen e zakonshme që u takon punonjësve për periudhën kur në fakt merret leja e zakonshme prej tyre.

3.10 Provizionet

Provizioni njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të bëhet një vlerësim relativisht i sakte i shumës së detyrimit.

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

3.11 Tatimi aktual mbi fitimin

Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin e shtyrë. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël.

Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korrigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat". Menaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumën që parashikon të paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Një paraqitje e përmbledhur e tyre jepet në tabelën vijuese:

Gjendja e "Aktiveve Monetare" me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet: si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Arka	1.764.957 leke	4.416.730 leke
Banka	27.149.218 leke	36.779.419 leke
Totali	28.914.175 leke	41.196.149 leke

Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2019 të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat.

Shoqeria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

4.1. Mjetet monetare në llogaritë bankare

Gjendja e llogarive bankare në fund të periudhës 2019 dhe 2018 paraqitet si vijon:

	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Gjendje ne llogari bankare në lekë	8.058.505	15.529.672
Gjendje në llogari bankare në euro	18.839.646	19.601.071
Gjendje në llogari bankare në dollarë	251.067	1.648.676
Totali	27.149.218	36.779.419

Ne menyre analitike ne zeri " **Banka** " jane perfshire tepricat e llogarive bankare me 31.12.2019 si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
• B.K.T.	6.033.537 leke	4.088.359 leke
• Raiffeisen Bank	323.390 leke	8.725.649 leke
• Tirana Bank	5.409.279 leke	5.006.916 leke
• Alpha Bank	5.981.200 leke	12.856.476 leke
• Intesa San Paolo	2.718.707 leke	1.229.133 leke
• F.I. Bank	175.554 leke	40.206 leke
• ABI Bank	70.803 leke	382.210 leke
• N.B.G.	0 leke	318.392 leke
• O.T.P Bank	3.074.004 leke	2.732.013 leke
• Credins Bank	2.940.659 leke	268.702 leke
• Union Bank	35.465 leke	92.413 leke
• Piraeus Bank	386.620 leke	1.038.950 leke
Totali	27.149.218 leke	36.779.419 leke

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Mjetet monetare jane paraqitur ne bilanc sipas gjendjeve te llogarive bankare ne daten e fundit,31.12.2019, e cila eshte e njejte me ekstratet e fundit te bankave per kete periudhe .

4.2 Mjetet monetare në arkë

Gjendja e likuiditeteve në arkë në vitin 2019 përbëhet nga shumat e mjeteve monetare në monedhën kombëtare lek dhe në euro që ndodhen gjendje në shoqëri në 31.12.2019 në arkën qendrore dhe arkat e tjera.

	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Gjendje na arkë në lekë	1.764.957	4.416.730
Totali	1.764.957	4.416.730

5.Llogari Kërkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2019. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientëve jepet në tabelën vijuese:

<i>Llogari/Kërkesa të arkëtueshme</i>	Viti 2019	Viti 20XX-1
	Në lekë	Në lekë
Kliente vendas	247.583.747	181.625.199
Kliente te huaj	105.797.188	75.096.756
Totali	353.380.935	256.721.955

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

6.Kërkesa të arkëtueshme të tjera

Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

- Zeri " Te tjera te arketueshme " perfshin:

	31 Dhjetor 2019
Dogana	94.418 leke
Garanci AMC	19.875 leke
Garanci M.S.C.	37.847 leke
Pag. Dogan. ankimuar	1.404.785 leke
Totali	1.556.925 leke

Aktivet Afatshkurtera – Te drejta te arketueshme (Kerkesa te arketueshme dhe Te tjera te arketueshme) krahasuar me vitin e kaluar kane pesuar rritje ne total .

Me 31.12.2018 ky ze ishte – 262.593.427 leke

Si rezultat kerkesat afatshkurtera kane nje rritje ne vleren 92.344.433 leke .

7.Inventarët

Shoqëria përdor disa lloje të inventarëve të nevojshëm për aktivitetin e vet. Shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit të vazhdueshëm për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventarët janë vlerësuar me kosto e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si me e vogla e krahasuar me vlerën neto të realizueshme. Gjendja e inventarëve sipas llojeve të tyre paraqitet si vijon:

Gjendja e "Inventareve" me date 31 Dhjetor 2019 krahasuar me 2018 paraqitet:

Lende te para, materiale	602.841.369 leke	589.735.995 leke	13.105.374 leke
Produkte te gatshme	61.696.055 leke	55.120.515 leke	6.575.540 leke
DIFERENCA			19.680.914 leke

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Ne total kemi nje rritje prej 19.680.914 leke prej ku ne strukture mund te themi se zeri:

- Lende te para, materiale ka nje rritje prej	13.105.374 leke
- Produkte te gatshme ka nje rritje prej	6.575.540 leke
Total (rritje)	19.680.914 leke

Inventari i "Stokut" me 31.12.2019 paraqitet ne Pasqyren e " Iventarit te Stokut gjendje me 31.12.2019 "

- Parapagesat per inventar jane pagesa ne forme paradhenie qe kompania u ka bere furnitoreve te saj per blerje malli ne vlere – 5.357.029 leke (Lista analitike me vlerat perkatese pasqyrohet ne kartelen e Furnitoreve te kompanis me 31.12.2019)

8.Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet ne tabelën me poshtë:

Parapagime, shpenzime te shtyra	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Shpenzime të periudhave të ardhme - Të tjera	241.783	0
Totali	241.783	0

Shpenzime të periudhave të ardhme - Të tjera paraqesin shumen e shpenzimeve të tjera që lidhen me prenotime bileta avioni per udhetime pune ne funksion te objektit te shoqerise qe do kryhen 2020.

9. Aktivët Afatgjatë

Gjendja dhe shtesat e pakësimit e Aktiveve Afatgjatë Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2019 paraqiten si në tabelën vijuese:

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Gjendja e "Aktiveve Afatgjata Materiale" sipas grupimeve ne strukture me date 31.12.2019 paraqitet si me poshte:

Gjendja e Aktiveve Afatgjata Materiale ne date 31.12.2019						
Pershkrimi	Toka	Ndertesa	Makineri & Mjete Transporti	Te tjera Aktive	Totali	
Aktive te Trupezuara						
Gjendje 01.01.2019	677.175.566	138.205.964	176.559.379	27.681.590	1.019.622.499	
Shtesa	-	-	28.633.248	963.891	29.597.139	
Pakesime	-	-	-1.000.000	-	-1.000.000	
Gjendje 31.12.2019	677.175.566	138.205.964	204.192.627	28.645.481	1.048.219.638	
Amortizimi						
Gjendje 01.01.2019	-	45.069.246	138.675.456	17.968.949	186.804.059	
Shtesa	-	4.656.836	12.286.995	2.000.281	15.068.298	
Pakesime	-	-	-964.747	-	-158.706	
Gjendje 31.12.2019	-	49.726.082	149.997.704	19.969.230	201.713.651	
Vlera neto 31.12.2018	677.175.566	93.136.718	37.149.266	9.712.641	817.908.848	
Vlera neto 31.12.2019	677.175.566	88.479.882	54.194.923	8.676.251	828.526.622	

Ne total "Aktivet Afatgjata Materiale" kane nje rritje neto ne vleren 10.617.774 lek kurse shtesat,pakesimet,amortizimet dhe vlera e mbetur ose kostoja e amortizuar paraqitet edhe ne Aneksin e " Pasqyres se Amortizimit te Aktiveve Materiale Afatgjata " per vitin 2019

. Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar.

Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura janë në përputhje me kërkesat e Ligjit 8438 date 28.12.1998, "Për Tatimin mbi te ardhurat".

9.1 Aktive të tjera Afatgjata jomateriale

Në këtë zë nuk është paraqitur asnjë vlerë.

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

10. Detyrimet

Detyrimet e shoqërisë në bilanc paraqiten si vijon:

D E T Y R I M E	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
<i>Detyrime afatgjata</i>	257.594.637	45.339.000
<i>Detyrime afatshkurtra</i>	210.636.798	392.281.299
Totali	468.231.435	437.620.299

10.1 Detyrimet afatshkurtra

Paraqitja e detyrimeve afatshkurtra tregtare ne bilancin kontabël jepet si ne tabelën qe vijon:

	<i>Detyrimet Afatshkurtra</i>	<i>31 Dhjetor 2019</i>		<i>31 Dhjetor 2018</i>		<i>Ndryshimi +/-</i>
1	<i>Derivativet (vlera negative)</i>	-		-		-
2	<i>Huat dhe obligacionet afatshkurtra</i>	-		-		-
3	<i>Kthimet/ripagesat e huave afatgjata</i>	-		-		-
4	<i>Bono te konvertueshme</i>	-		-		-
5	<i>Te pagueshme ndaj furnitoreve</i>	188.762.289		131.028.318		-57.733.971
6	<i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>	38.744		-		38.744
7	<i>Detyrimet tatimore</i>	8.703.915		3.141.018		5.562.897
8	<i>Detyrime te tjera</i>	3.806.304		254.943.789		-251.137.485
9	<i>Parapagimet e arkëtuara</i>	9.325.546		3.168.174		6.157.372
10	<i>Grantet dhe te ardhurat e shtyra</i>	-		-		-
11	<i>Provizionet afatshkurtra</i>	-		-		-
	TOTALI	210.636.798		392.281.299		-181.644.501

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Ne total ka nje rrenie ne zerin e " Detyrimeve Afatshkurtra" ne vleren 181.644.501 leke. Ne zerin ' Parapagime te arketuara " – 9.325.546 leke jane paradhenie nga kliente brenda vendit per te cilet kompania ka prere dhe fature TVSH . Ne vitin 2018 ne zerin ‘ Parapagime te arketuara “ – 3.168.174 leke vlere prej 2.581.606 leke jane paradhenie nga kliente brenda vendit per te cilet kompania ka prere dhe fature TVSH kurse vlere 586.568 leke jane paradhenie kliente jashte vendit.

Ne zerin ' Detyrimet e tjera " faktori kryesor per rrenien nga viti 2018 eshte riklasifikimi i bere i detyrimeve te cilat nuk jane shlyer brenda afatit 1 vjecar dhe kane kaluar e pasqyruar tek detyrimet afatgjata ne bilanc.

10.2 Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2019. Detyrimet në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit publikuar nga Banka e Shqipërisë dhe diferencat janë sistemuar në rezultatin e periudhës. Një paraqitje analitike e këtyre detyrimeve jepet në tabelën vijuese:

<i>Të pagueshme ndaj furnitorëve</i>	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Furnitorë vendas	55.180.243	28.814.723
Furnitorë të huaj	133.582.046	102.213.595
Totali	188.762.289	131.028.318

10.3 Të pagueshme ndaj punonjësve

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet ndaj punonjësve për pagat e llogaritura e të papaguara. Në vijim jepet paraqitja e tyre:

<i>Të pagueshme ndaj punonjësve</i>	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Pagat e llogaritura	38.744	0
	38.744	0

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

10.4 Detyrimet tatimore

Në këtë grup paraqiten detyrimet ndaj shtetit për Tatimet e taksat si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Një paraqitje e detajuar e këtyre detyrimeve jepet në vijim:

Gjendja e *Detyrimeve Tatimore* me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

PERSHKRIMI	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018	Ndryshimi +/-
Tatim mbi fitimin	1.087.886	-	1.087.886
TVSH per tu paguar	5.834.786	1.483.815	4.350.971
Tatim ne burim	552.952	633.607	-80.655
Sigurime shoqërore e Shendetesore	1.116.985	942.853	174.132
Tatim mbi te ardhurat personale	111.306	80.743	30.563
Gjobe tatimore	-	-	
Totali	8.703.915	3.141.018	5.562.897

Detyrimet tatimore kane nje rritje se viti kaluar.Ne strukture te detyrimve tatimore " Tatim fitimi" paraqitet me mbetje kreditore dhe eshte pasqyruar ne Pasiv te pasqyrave ne zerin " Detyrime Tatimore " ne vleren 1.087.886 leke. Kjo per arsye se shoqëria ka paguar gjate vitit 2019 nje vlere me te vogel se Tatim Fitimi qe rezulton sipas Bilancit. Kjo teprice kreditore vjen si rezultat i diferences se teprices debitore ne vlere 17.784.564 leke me tepricen kreditore ne vlere 18.872.450 leke tatim fitimi qe rezulton sipas Bilancit 2019. Gjithashtu " Sigurime shoqërore e shendetesore " ka nje rritje nga viti 2018 ne vleren 174.132 leke , " Tatim mbi te ardhurat personale " kane nje rritje nga viti i kaluar ne vleren prej 30.563 leke ndersa " Tatim ne burim " ka nje rrenie ne vlere 80.655 leke.

TVSH për tu paguar paraqet shumën e TVSH për tu paguar të llogaritur për muajin dhjetor 2019 e të paguar në muajin janar 2020

Tatimi mbi fitimin paraqet shumën e detyrimit të llogaritur mbi fitimin faktik të tatueshëm për vitin 2019 dhe që paguhet branda datës 31 mars 2020.

Shoqeria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Tatimi mbi fitimin eshte shuma e tatim fitimit qe shoqeria ka llogaritur si detyrim per vitin 2019 sipas deklarates se tatim fitimit

<i>Tatim Fitimi i perllogaritur ne fund te vitit 2019</i>	<i>18.872.450 leke</i>
<i>Pagesa gjate vitit 2019</i>	<i>17.784.564 leke</i>
<i>Tatim Fitim per tu paguar per vitin 2019</i>	<i>1.087.886 leke</i>

10.5 Hua dhe detyrime të tjera

Në këtë zë paraqiten marrëdhëniet detyruese të shoqërisë me të tjerë jo furnitorë. Këtij vit. Vlera 3.806.304 leke eshte interesi qe kompania duhet te paguaj sipas kontrates se huadhenies me te trete dt 10.02.2018 nr214rep/ nr86/4 kol

10.6 Detyrimet afatgjata

Në këtë zë të bilancit eshte perfshire nje kontrate financimi dt 02.02.2018 ne vlere 45.339.000 lek me kompanine Palsada Holding per blerjen e nje trualli –ndertese. Pjesa tjeter jane detyrime afatgjata qe kompania ka ndaj ortakeve te shoqerise dhe te treteve. Per vitin 2019 eshte bere riklasifikim e detyrimeve te cilat nuk jane shlyer brenda afatit 1 vjecar dhe jane kaluar nga " Detyrime Afatshkurtra " dhe perfshire ne zerin e " Detyrimeve Afatgjata".

Shoqeria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

11. Kapitallet e veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2019, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Gjendja e grupit te Kapitaleve me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

	<i>Kapitali</i>	<i>31 Dhjetor 2019</i>		<i>31 Dhjetor 2018</i>		<i>Ndryshimi +/-</i>
1	<i>Aksionet e pakices</i>	-		-		-
2	<i>Kapitali qe i perket aksionareve te sh. meme</i>	-		-		-
3	<i>Kapitali Aksioner</i>	1.215.675.521		1.215.675.521		-
4	<i>Primi i aksionit</i>	-		-		-
5	<i>Njesite ose aksionet e thesarit</i>	-		-		-
6	<i>Rezerva ligjore</i>	35.649.543		31.176.029		4.473.514
7	<i>Rezerva te tjera</i>	-		-		-
8	<i>Rezerva statuore</i>	-		-		-
9	<i>Fitimet e pashperndara</i>	58.476.011		957		58.475.054
10	<i>Fitimi/Humbja e vitit financiar</i>	104.482.383		89.470.270		15.012.113
	TOTALI	1.414.283.458		1.336.322.777		77.960.681

Kapitali ne strukturen e tij ka ndryshime si rezultat i verpimeve me fitimet e vitit te meparshem 2018. Nga fitimet e vitit te meparshem eshte kaluar ne rezerva ligjore te shoqerise shuma prej 4.473.514 lek. Ne vitin 2019 sipas V.A. dt 24.06.2019 ortaket kane vendosur te shperndajne dividend nga fitimet e vitit 2018 ne shumen prej 26.521.702 lek.

Shuma prej 58.476.011 lek kane mbetur Fitim i pashperndare . Per te gjith vleren e dividendin te percaktuar 26.521.702 eshte paguar tatim per dividend prej 2.121.736 lek dhe nga diferenca eshte terhequr nga ortaket vlere 24.399.966 lek .

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

12. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës.

12.1 Shitjet neto

Shoqëria realizon të ardhurat kryesore të aktivitetit të saj nga shitjet e produkteve të gatshëm, të mallrave për rishitje, të materialeve të ndryshme, etj. Në tabelën vijuese jepet një paraqitje e shitjeve neto

Shumat në Lekë				
Përshkrimi i Llogarive		31-dhjetor-19		31-dhjetor-18
<i>Të ardhura nga shitja e mallrave</i>		<i>525.148.151</i>		<i>493.685.931</i>
<i>Te ardhura nga shitja e Produkteve</i>		<i>412.287.974</i>		<i>330.461.313</i>
<i>Te ardhura nga sherbime</i>		<i>3.125.435</i>		<i>2.324.850</i>
<i>Te ardhura nga shitje AAM</i>		<i>220.000</i>		<i>435.043</i>
<i>Te ardhura nga qera</i>		<i>10.909.322</i>		<i>8.769.397</i>
Totali		951.690.882		835.676.534

Ne zerin " Te ardhura nga sherbime " jane perfshire : Te ardhura nga sherbime per te trete ne vleren 3.125.435 leke

-Të ardhurat e tjera nga veprimtarit e shfrytezimit

Te ardhurat e tjera nga veprimtaria e shfrytezimit ne shumen prej 310.218 leke perfshin:

- 1. Te ardhura nga skonto(kredit note)te tjera* = *105.278 leke*
- 2. Te ndryshme* = *204.940 leke*

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shënime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

12.2 Ndryshimi i gjendjes së produkteve të gatshme

Në këtë zë përfshihet efekti i ndryshimit të gjendjes së produkteve të gatshme në rezultatit e periudhës. Ky ndryshim i analizuar sipas produkteve paraqitet si vijon:

Ndryshimi i gjendjes se Produkteve të gatshme	Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi
	Në lekë	Në lekë	
<i>Lende te para</i>	-13.105.374	-121.768.469	108.663.095
<i>Produkte te gatshme</i>	-6.575.540	1.975.715	-8.551.255
Totali	-19.680.914	-119.792.755	100.111.839

12.3 Shpenzimet lëndëve të para e materialeve të tjera (K.M.SH.)

Përbërja e këtij zëri paraqitet në tabelën vijuese:

Materialet e konsumuara	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Blerje Materiale te para	676.274.924	707.335.483
Ndryshim i gjendjes	-13.105.374	-119.792.755
K.M.SH	663.169.550	587.542.728

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

12.4 Shpenzime personeli

Ne shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2019. Gjate vitit shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar ne përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit. Një paraqitje e përbërjes së tyre jepet si vijon:

Shumat në Lekë				
Përshkrimi i Llogarive		31-dhjetor-19		31-dhjetor-18
Pagat		43.947.568		39.066.577
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore		7.378.742		6.533.185
TOTAL		51.326.310		45.599.762

Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore paraqiten shuma e kontributeve që llogarit dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifatat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetësore në fuqi gjatë vitit 2019.

Shoqëria " VEKO "SHPK**NIPT K 12511628 P****Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019****12.5 Shpenzimet e amortizimeve dhe zhvlerësimeve**

Përbërja e këtyre shpenzimeve jepet në tabelën vijuese:

Shumat në Lekë			
Përshkrimi i Llogarive		31-dhjetor-19	31-dhjetor-18
Amortizimi		18.944.112	15.068.298
Totali		18.944.112	15.068.298

Pasqyra analitike e amortizimit:

TE TRUPEZUARA	AMORTIZIMI				
	CELJA	NORMA	SHTESA	PAKESIMI	MBETJA
NDERTESA	45,069,246	5%	4,656,836	0	49,726,082
MAKINERI E PAJISJE	113,192,772	20%	10,597,442	0	123,790,214
MJETE TRANSPORTI	25,482,684	20%	1,689,553	964,747	26,207,490
AKTIVE TE TJERA AFATGJATE	17,968,949	20%	2,000,281	0	19,969,230
	201,713,651		18,944,112	964,747	219,693,016

Me analitikisht te dhenat e mesiperme jane trajtuar edhe ne Pasqyren e Amortizimit te Aktiveve Materiale Afatgjate.

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

12.6 Shpenzimet e tjera

Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet e tjera të aktiviteti kryesor të shoqërisë. Përbërja e tyre jepet në tabelën në vijim:

Në shpenzimet e tjera të shfrytëzimit në vlerë prej 113.075.821 leke janë përfshirë shpenzimet e pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Shumat në Lekë

<i>Përshkrimi i Llogarive</i>	<i>31-dhjetor- 2019</i>	<i>31-dhjetor- 2018</i>
<i>Vlera kontabel e A.A.M</i>	<i>35.253</i>	<i>377.525</i>
<i>Energji Elektrike ,uje etj</i>	<i>14.557.999</i>	<i>13.521.358</i>
<i>Mirembajtje dhe riparime</i>	<i>10.460.627</i>	<i>10.484.733</i>
<i>Sigurime automjete, prone</i>	<i>2.193.138</i>	<i>2.198.859</i>
<i>Udhëtimi dhe dieta</i>	<i>3.961.608</i>	<i>3.686.835</i>
<i>Postare dhe telekomunikimi</i>	<i>1.201.704</i>	<i>1.183.957</i>
<i>Shpenzime transporti</i>	<i>7.364.864</i>	<i>8.174.112</i>
<i>Shërbime Bankare në vlerën neto</i>	<i>2.080.109</i>	<i>1.969.108</i>
<i>Taksa vendore lokale</i>	<i>3.098.930</i>	<i>3.835.382</i>
<i>Taksa regjistrimi automjete</i>	<i>412.416</i>	<i>421.433</i>
<i>Gjoha e demshperblime</i>	<i>45.939</i>	<i>25.470</i>
<i>Shpenzime të tjera</i>	<i>67.663.234</i>	<i>36.512.525</i>
TOTAL	113.075.821	82.391.297

Në shpenzimet për mirëmbajtje e riparime përfshihen shpenzimet e bëra për riparimin e makinerive të prodhimit, të mjeteve të transportit të shpërndarjes, të ndërtesës së magazinës, të sistemit informatik, etj.

Shpenzimet e siguracionit paraqesin shpenzimet për sigurimin e pronës dhe automjeteve.

Shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujë, paraqesin vlefën e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar në kapononin për prodhimin dhe administrimin.

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Shpenzimet e ndryshme paraqesin shpenzimet e ndryshme te kryera per aktivitetin,(shpenzime kancelari, pritje-percjellje, shpenzime noteriale, konsulenca ligjore, ekonomike, arkitekturore, shpenzime marketingu dhe reklame ne funksion te aktivitetit te kompanise etj) .

12.6.a) Shpenzime për tatime e taksa

Ne shpenzimet për tatime e taksa e te ngjashme janë përfshirë pagesat si ne tabelën e mëposhtme:

Shpenzime tatime e taksa	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Taksa Vendore	3.070.593	3.804.382
Shpenzime Kolaudime Automjete	71.173	67.977
Taksa Qarkullimi Automjete	362.580	377.456
Taksa Ministria e Mjedisit	7.000	7.000
Totali	3.511.346	4.256.815

12.6.b) Gjoha, Penalitete, e të ngjashme

Ne këtë zë është përfshirë gjoha (kamatvonesa) per taksa te bashkise Tirane ne vlere 45.939 leke

12.6.c) Mallra të dëmtuara e të skaduara

Nuk ka

12.6 d) Vlera Kontabël e AAM të nxjerra e të shitura

Në këtë zë të Shpenzimeve për vitin 2019 paraqitet vlera kontabël e AAM-ve të shitura gjatë vitit ne vlere 35.253 leke

Shoqeria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

12.7 Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa

Në zërin të Ardhura dhe Shpenzime për interesa janë përfshirë diferencat ndërmjet të Ardhurave dhe Shpenzimeve për interesat. Paraqitja si vijon:

Të ardhura dhe shpenzime nga interesat	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Shpenzime për interesat e huave të marra	3.354.649	3.394.172
Të ardhura nga interesat	-	-
Totali	3.354.649	3.394.172

Ne kete ze per vitin 2019 shoqeria ka pasqyruar vleren e interesit nga kontrata e financimit (huase) dt 10.02.18 nr 214 rep36/4 kol qe eshte 3.354.649 leke .

12.8 Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditetevete shprehura ne monedha te huaja. Paraqitja e tyre jepet ne tabelën vijuese:

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare që rrjedhin nga kursi i këmbimit janë paraqitur me vleren neto (humbje - të ardhura nga kursi i këmbimit) prej -14.648.635 leke

- **Diferenca nga ndryshimi i kursit të këmbimit(KK). për transaksione në valute dhe vleresimi i detyrimeve ndaj furnitoreve (në valute të huaja) më 31.12.2019 sipas K.K. të Bankes së Shqipërisë**

<i>"Të ardhura nga ndryshimi i K.K. "</i>	<i>4.732.706 leke</i>
<i>" Shpenzime nga ndryshimi i K.K. "</i>	<i>1.376.773 leke</i>
<i>Diferenca neto rezulton fitim</i>	<i>3.355.933 leke</i>

Shoqeria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

- Diferenca nga rivleresimi i klienteve (ne valute te huaj) me 31.12.2019 sipas K.K. te Bankes se Shqiperise

<i>"Te ardhura nga ndryshimi i K.K. "</i>	<i>62.921 leke</i>
<i>" Shpenzime nga ndryshimi i K.K. "</i>	<i>2.119.427 leke</i>
<i>Diferenca neto rezulton Humbje</i>	<i>(2.056.506) leke</i>

- Diferenca nga vleresimi i mjeteve monetare (ne valute te huaj) sipas K.K. te Bankes se Shqiperise me 31.12.2019

<i>" Te ardhura nga ndryshimi i K.K. "</i>	<i>108.650 leke</i>
<i>" Shpenzim nga ndryshimi i K.K. "</i>	<i>1.177.050 leke</i>
<i>Diferenca neto rezulton Humbje</i>	<i>(1.068.400) leke</i>

- Gjithashtu nga vleresimi i Huase ndaj te treteve (ne valute te huaj) sipas K.K te Bankes se Shqiperise me 31.12.2019 ka rezultuar e ardhur ne vlere 14.605.064 leke

Diferenca nga ndryshimet e kurseve (kurse te konvertimit) sipas tabelave te mesiperme rezulton ne TOTAL nje Fitim ne vleren prej **14.648.635** leke (Fitim prej 19.509.341 leke - Humbje prej 4.860.706 leke)

Pasqyra permbledhese e të ardhurave dhe shpenzimet financiare që rrjedhin nga kursi i këmbimit

Shumat në Lekë		
Përshkrimi i Llogarive		31-Dhjetor-19
<i>Te ardhura nga Kurset e këmbimit</i>		<i>19.509.341 leke</i>
<i>Shpenzime nga Kurset e këmbimit</i>		<i>4.860.706 leke</i>
Total (Vlera neto – Fitim)		14.648.635 leke

Shoqëria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

13. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një fitim neto kontabël para tatimit prej 123.354.833 lekë dhe me një fitim neto pas tatimit prej 104.482.383 leke. Për llogaritjen e rezultatit tatimor të vitit 2019 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura për qëllime fiskale një sere shpenzimesh. Fitimi i tatueshëm i shoqërisë për vitin 20, pas rregullimeve me shpenzimet e panjohura për qëllime tatimore rezulton 125.816.336 lekë.

Shoqëria, duke zbatuar kërkesat e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" ka llogaritur si shpenzime të panjohura, për efekte tatimore për këtë periudhë një shumë prej 2.461.503 leke.

Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe e rezultatit fiskal për gjithë vitin 2019 paraqiten si në tabelën vijuese:

	Viti 2019	Viti 2018
Fitimi /Humbja e vitit	123.354.833	105.580.956
SHPENZIME TE PAZBRITSHME	2.461.503	1.823.617
Gjoha të tjera të paguara	45.939	25.470
Shpenzime Udhetime, dieta	535.811	35.744
Shpenzime të panjohura mirembajte e riparime	20.926	0
Shpenzime të panjohura për automjetet	1.854.417	1.669.616
Shpenzime të ndryshme të panjohura	4.410	92.787
Rezultati fiskal i vitit 2019	125.816.336	107.404.573
Humbja fiskale e mbartur nga vitet e mëparshme	0	0
Fitimi fiskal për vitin 2019	125.816.336	107.404.573
Tatimi mbi fitimin me tarifën 15%	18.872.450	16.110.686
Rezultati neto i bilancit	104.482.383	89.470.270

Shoqeria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

14. Transaksione me Palët e lidhura

Gjatë vitit transaksionet me palët e lidhura konsistojnë në huan e marrë nga ortakët e saj, si dhe llogaritja për interesat lidhur me këto hua. Një paraqitje e transaksioneve dhe tepricave të tyre ne fund jepet si me poshtë:

	Viti 2019 Në lekë	Viti 2018 Në lekë
Detyrim - Hua nga ortaku	50.675.149	61.118.739
Totali	50.675.149	61.118.739

Sic shikohet ne celje viti 2019 detyrimi ndaj ortakeve te shoqerise ka qene 61.118.739 lek. Gjate vitit 2019 shoqeria ka bere transaksione me ortaket duke paguar ndaj tyre ne vlere prej 10.443.590 lek . Si rrjedhim ne 31.12.2019 rezulton qe shoqeria ka detyrim per te paguar ndaj ortakeve vleren 50.675.149 lek

15. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

Shoqeria " VEKO "SHPK

NIPT K 12511628 P

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Mardheniet me shtetin

Lidhur me rakordimin e situates tatimore me ate te pasqyrave financiare te shoqerise rezulton se ne fund te vitit shoqeria ka detyrimet tatimore te paraqitura ne Shenimet Shpjeguese/Pasivi/Detyrimet Afatshkurtra (e)/ Detyrimet tatimore.. Gjithashtu nga krahasimi I te ardhurave te raportuara ne FDP-e mujore me ato te pasqyruara ne pasqyren P.A.SH rezulton se :

Totali I te ardhurave te raportuar ne FDP-e mujore - 958.357.734 leke

Nga ana tjeter shoqeria ne pasqyrat financiare te kompanise ka pasqyruar te ardhura ne vlere totale

- Te ardhura per vitin 2019	969.870.626 leke
- Saktesuar nga arketime ne avance per porosi gjate vitit 2019	- 2.581.606 leke
- Gjendja e arketimeve ne avance me 31.12.2019	+ 9.248.458 leke
- Te ardhura ndryshimi gjendjes produktit	- 6.575.540 leke
-Te ardhura te tjera skonto furnitori etj (padeklaruar FDP)	- 310.218 leke
- Te ardhura financiare	- 11.293.986 leke

T O T A L I

958.357.734 leke

Te ardhura financiare nga kurset e kembimit ne vleren NETO (humbje – fitime) ne vlere 14.648.635 leke jane pasqyruar sipas kerkesave te SKK 12, ne pasqyrat financiare te shoqerise ndersa ne FDP nuk pasqyrohen . Gjithashtu edhe tek te ardhurat nga ndryshimi i gjendjes se produktit si dhe te ardhurat e tjera te shfrytezimit prej 310.218 leke jane te ardhura te ndryshme nga skonto,(kredit note) dhe sistemime e te tjera jane pasqyruar ne PASH por ne FDP nuk jane pasqyruar.

Kontabilisti

Administratori i Shoqerise

MAKSI ROZE

STAVRO KOCA